



**Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova  
Kosovo Chamber of Physiotherapists**

**KUVENDI I ODËS SË FIZIOTERAPEUTËVE TË KOSOVËS**, në mbështetje të nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.1 dhe paragrafit 1.2., në lidhje me nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, nenit 20 të Statutit të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 23.12.2021 nxjerrë këtë:

**KODI ETIK DHE DEONTOLOGJISË TË FIZIOTERAPEUTËVE**

**Neni 1**

**Dispozitat e përgjithshme**

1. Kodi Etik i Fizioterapeutëve ka të bëjë me reflektimin e ndryshimeve në legjislacion, ndryshimin në mënyrën e rregullimit të punës së fizioterapeutëve (themelimi i Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës), zhvillimeve të reja në lëmin e fizioterapisë si dhe nevojës për sigurimin e ofrimit të shërbimeve fizioterapeutike të bazuar në standarde të kompetencës profesionale.
2. Me Kodin Etik të Fizioterapeutëve përfshihen parimet e Konfederatës Botërore të Fizioterapisë, obligimet etike dhe masat disiplinore për shkelje të etikës profesionale (shtojcë aneksi i specifikuar i obligimeve etike dhe masave ndëshkuese).

**Neni 2**

**Parimet Etike**

1. Fizioterapeutët e Kosovës të cilët janë anëtarë në Odën e Fizioterapeutëve të Kosovës obligohen të:
  - 1.1. Respektojnë të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë individëve;
  - 1.2. Veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë praktikën e fizioterapisë në shtetin në të cilin ata ushtrojnë profesionin;
  - 1.3. Pranojnë përgjegjësinë për ushtrimin e gjyqimit të shëndoshë;
  - 1.4. Ofrojnë shërbime profesionale të ndershme, kompetente dhe të përgjegjshme;
  - 1.5. Ofrojnë shërbime cilësore;
  - 1.6. Kanë të drejtë për një nivel të drejtë të shpërblimit për shërbimet e tyre;

- 1.7. Sigurojnë informacione të sakta pacientëve/klientëve, agjencive të tjera dhe komunitetit rreth fizioterapisë dhe shërbimeve të cilat ofrojnë fizioterapeutët;
- 1.8. Kontribuojnë në planifikim dhe zhvillim të shërbimeve që adresojnë nevojat shëndetësore të komunitetit.

### **Neni 3**

#### **Respektimi i të drejtave themelore të njeriut**

1. Të gjithë personat që kërkojnë shërbime të fizioterapeutëve kanë të drejtë në shërbim, pavarësisht nga mosha, gjinia, raca, kombësia, feja, origjina etnike, besimi, ngjyra, orientimi seksual, aftësitë e kufizuara, gjendja shëndetësore apo politika.
2. Pacientët kanë të drejtë në: shërbime të kualitetit të mirë, informacion, dhënie të pëlqimit, konfidencialitet (besueshmëri), qasje në të dhëna, edukim shëndetësor, zgjedhin se kush (nëse paraqitet nevoja) duhet të informohet në emër të tij/saj.
3. Fizioterapeutët kanë përgjegjësi absolute të sigurohen se sjellja e tyre është në çdo kohë profesionale, duke siguruar se nuk mund të paraqitet potenciali për sjellje të pahijshme.
4. Fizioterapeutët kanë të drejtë të presin bashkëpunim nga kolegët e tyre.
5. Fizioterapeutët do të zbatojnë parimet e shëndosha të biznesit kur kanë të bëjnë me furnizuesit, prodhuesit dhe agjentët e tjerë.

### **Neni 4**

#### **Obligimet ndaj akteve juridike**

1. Fizioterapeutët obligohen të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë praktikën e fizioterapisë në shtetin e Kosovës ku ata e ushtrojnë profesionin.
2. Fizioterapeutët kanë të drejtë të refuzojnë të trajtojnë ose ndërhyjnë kur sipas mendimit të tyre shërbimi nuk është në interesin më të mirë të pacientit/klientit.

### **Neni 5**

#### **Përgjegjësitë për ushtrimin e gjykimit të shëndoshë**

1. Fizioterapeutët janë praktikues profesional të pavarur dhe autonom.
2. Fizioterapeutët bëjnë gjykime të pavarura në ofrimin e shërbimeve për të cilat ata kanë njohuri dhe aftësi dhe për të cilat mund të mbahen përgjegjës.
3. Për çdo individ të cilit i është ofruar shërbimi, fizioterapeutët ndërmarrin ekzaminim/vlerësim të duhur për ta mundësuar zhvillimin e një diagnoze fizioterapeutike.



4. Në bazë të diagnozës dhe informacioneve të tjera relevante në lidhje me pacientin, sidomos qëllimeve të pacientit, fizioterapeutët planifikojnë dhe zbatojnë intervenimin (trajtimin).
5. Fizioterapeuti ka te drejtën e ofrimit të diagnostifikimit fizioterapeutik duke marrë parasysh diagnostifikimin imazherik dhe rezultateve laboratorike.
6. Kur qëllimet janë arritur apo nuk mund të arrihen dobi të mëtejshme, fizioterapeutët do ta informojnë dhe lirojnë pacientin.
7. Kur diagnoza nuk është e qartë ose ndërhyrja/trajtimi i kërkuar është përtej kapacitetit të fizioterapeutit, fizioterapeuti do ta informojë pacientin dhe do të sigurojë ndihmë në lehtësimin e referimit tek personat e tjerë të kualifikuar.
8. Fizioterapeutët nuk do ta delegojnë asnjë aktivitet që kërkon aftësinë, njohurinë dhe gjykimin unik të fizioterapeutit.
9. Fizioterapeuti do të konsultohet me mjekun referues nëse programi i trajtimit ose vazhdimi i programit nuk janë në përputhje me gjykimin e fizioterapeutit.
10. Për çështjet të cilat nuk janë të rregulluar me legjislacionin e Republikës së Kosovës, fizioterapeuti veprimtarinë shëndetësore do ta ushtrojë në përputhje me parimet dhe rregullat e vendosura nga WCPT

## **Neni 6**

### **Shërbimet profesionale të ndershme, kompetente dhe të përgjegjshme**

1. Fizioterapeutët duhen siguruar se pacientët/klientët e kuptojnë natyrën e shërbimit që ofrohet, veçanërisht kostot e pritura, qofshin ato në aspektin e kohës apo financave.
2. Fizioterapeutët ndërmarrin programe të planifikuara dhe të vazhdueshme të zhvillimit personal të dizajnuara për t'i ruajtur dhe zgjeruar njohuritë dhe aftësitë profesionale.
3. Fizioterapeutët mbajnë shënime adekuate rreth pacientit/klientit për të mundësuar vlerësim efektiv të kujdesit ndaj pacientit/klientit, si dhe vlerësim të praktikës së fizioterapeutit.
4. Fizioterapeutët nuk do të zbulojnë asnjë informacion në lidhje me pacientin/klientin tek një palë e tretë pa lejen e pacientit/klientit ose informim paraprak, përveç nëse zbulimi i tillë kërkohet me ligj.
5. Fizioterapeutët marrin pjesë në observimin e kolegëve dhe format e tjera të vlerësimit të praktikës, rezultatet e të cilave nuk do të zbulohen tek një palë tjetër, pa lejen e fizioterapeutit.

6. Fizioterapeutët do të mbajnë të dhëna të mjaftueshme për ta lehtësuar matjen e performancës së shërbimit dhe do t'i vënë këto të dhëna në dispozicion për agjentët e tjerë, siç kërkohet nga marrëveshja e përbashkët.
7. Parimet etike që rregullojnë praktikën e terapisë fizike do të kenë përparësi mbi çfarëdo biznesi ose praktike të punës. Aty ku paraqitet konflikt i tillë fizioterapeuti do të bëjë të pamundurën për të rregulluar këtë çështje, duke kërkuar ndihmën e Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës nëse është e nevojshme.
8. Fizioterapeutët nuk do të lejojnë që shërbimet e tyre të keqpërdoren.

### **Neni 7** **Cilësia e shërbimeve**

1. Fizioterapeutët do të jenë të vetëdijshëm për standardet aktualisht të pranura të praktikës dhe do ndërmarrin aktivitete që janë në përputhje me ato.
2. Fizioterapeutët do të marrin pjesë në edukim të vazhdueshëm për t'i rritur njohuritë e tyre themelore dhe për të siguruar njohuri të reja.
3. Fizioterapeutët do të mbështesin kërkimin që kontribuon në përmirësimin e shërbimeve ndaj pacientit/klientit.
4. Fizioterapeutët do të mbështesin edukimin cilësor në mjedise akademike dhe klinike.
5. Fizioterapeutët e angazhuar në hulumtim do t'i përmbahen rregullave dhe politikave aktuale që kanë të bëjnë me kryerjen e hulumtimeve mbi subjekte njerëzore duhet të sigurojnë: pëlqimin e subjekteve, konfidencialitetin (besueshmërinë) ndaj subjektit, sigurinë dhe mirëqenien e subjekteve, mungesën e mashtrimit dhe plagjiaturës, zbulimin e plotë të mbështetjes, dhe njohjen (pranimin, mirënjohjen) e duhur të ndihmës së çdo shkelje e rregullave të raportohet tek autoritetet përkatëse.
6. Fizioterapeutët do t'i ndajnë lirisht rezultatet e hulumtimeve të tyre, sidomos në revista dhe prezantime në konferenca.

### **Neni 8** **Fizioterapeuti si punëdhënës obligohet:**

1. Fizioterapeutët në rolin e punëdhënësit duhet:
  - 1.1. Të sigurohen se të gjithë të punësuarit janë të kualifikuar siç duhet, duke siguruar pajtueshmërinë me kërkesat statutores.



- 1.2. Të zbatojnë parimet dhe praktikat e tanishme të menaxhimit për udhëheqje të shërbimit, me vëmendje të veçantë në standardet e duhura të menaxhimit të personelit.
- 1.3. Të sigurojnë zbatimin dhe monitorimin e duhur të politikave dhe procedurave.
- 1.4. Të sigurojnë vlerësimin dhe auditimin e duhur të praktikës klinike.
- 1.5. Të ofrojnë mundësi adekuate për arsimim dhe zhvillim personal të personelit në bazë të vlerësimit efikas të performancës.

### **Neni 9**

#### **Shpërblimet për shërbimet e ofruara**

1. Fizioterapeutët duhet të sigurohen që çmimet (tarifa) e tyre është e bazuar në vlerësime të arsyeshme.
2. Fizioterapeutët duhen munduar të sigurohen se tarifatat e një pale të tretë janë të bazuara në vlerësime të arsyeshme.
3. Fizioterapeutët nuk duhet ta përdorin ndikimin e tyre për përfitime personale.

### **Neni 10**

#### **Informimi i pacientit dhe komunitetit**

1. Fizioterapeutët do të marrin pjesë në programet publike të edukimit, duke ofruar informacione rreth profesionit.
2. Fizioterapeutët kanë për detyrë ta informojnë publikun dhe profesionistët referues rreth natyrës së shërbimit të tyre në mënyrë që individët të jenë në gjendje të marrin vendime në lidhje me shfrytëzimin e shërbimit.
3. Fizioterapeutët mund t'i reklamojnë shërbimet e tyre.
4. Fizioterapeutët nuk do të përdorin deklarata apo pretendime të rreme, mashtruese ose të padrejta.
5. Fizioterapeutët do të pretendojnë vetëm ata tituj të cilët përshkruajnë saktë statusin e tyre profesional.

**Neni 11**  
**Planifikimi dhe zhvillimi i shërbimeve fizioterapeutike për nevojat shëndetësore të komunitetit**

1. Fizioterapeutët kanë për detyrë dhe obligim të marrin pjesë në planifikimin dhe dizajnimin e shërbimeve optimale shëndetësore në komunitet.
2. Fizioterapeutët janë të obliguar të punojnë drejt arritjes së drejtësisë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë njerëzit.

**Neni 12**  
**Shqiptimi i masave disiplinore**

1. Varësisht nga shkeljet e konstatuara dhe shqyrtimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese për anëtarin, Këshilli Etik shqipton këto masa disiplinore:
  - 1.1. Rekomandim kolegjial;
  - 1.2. Kërkim falje ndaj pacientit;
  - 1.3. Qortim ose qortim publik;
  - 1.4. Arsimim shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim;
  - 1.5. Trajtimi i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe vese të tjera;
  - 1.6. Tërheqja e përkohshme (0-1 vit) ose e përhershme e licencës dhe/ose fshirja e fizioterapeutit nga regjistri i OFTK-së;
  - 1.7. Dënimi me të holla një mijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro për çdo shkelje të ligjit, detyrave profesionale dhe etike.
2. Në funksion të transparencës së punës së Këshillit Etik si dhe evitimit të subjektivitetit me rastin e shqiptimit të masave disiplinore, më poshtë janë kategorizuar shkeljet e mundshme si dhe masat e caktuara disiplinore konform këtyre shkeljeve.

**Neni 13**  
**Shkeljet Etike për të cilat shqiptohet masa disiplinore**

1. Mos komunikimi dhe mosbashkëpunimi me kolegë nga profesioni dhe nga profesionet tjera shëndetësore në të mirë të trajtimit apo kujdesit ndaj pacientit;
2. Sjellja jo-etike apo ofendimi i kolegëve dhe pacientëve gjatë ushtrimit të profesionit;
3. Refuzimi i dhënies së ndihmës profesionale kolegëve gjatë ushtrimit të profesionit;
4. Kur fizioterapeuti kryen veprime apo sjellje të cilat pengojnë punën profesionale të tjerëve;
5. Kur konstatohet se në vendin e punës mungojnë procedurat e shkruara rreth ankesave të mundshme dhe mos njoftimi i palëve për ato.

#### **Neni 14**

##### **Shkeljet Etike për të cilat shqiptohet masa disiplinore –Kërkim falje ndaj pacientit**

1. Dështimi në promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së pacientit gjatë ushtrimit të profesionit;
2. Mos komunikim efektiv me pacientin dhe pamundësia e përshtatjes së mënyrës së komunikimit me nevojat e pacientit;
3. Dështimi në sqarimin e pacientit për opsionet e mundshme të trajtimit apo kujdesit, duke përfshirë rreziqet dhe dobitë në mënyrë që pacientit t'i mundësohet zgjedhje e arsyeshme për të;
4. Dështimi në identifikimin e pacientëve me nevoja specifike dhe të ofroj kujdes dhe shërbime bazuar në ato nevoja;
5. Dështimi në trajtimin e pacientit me respekt gjatë ushtrimit të profesionit.

#### **Neni 15**

##### **Shkeljet Etike për të cilat shqiptohet masa disiplinore –Qortim apo Qortim Publik**

1. Mosrespektimi i konfidencialitetit të informatave të siguruar rreth pacientit;
2. Mosrespektimi i të drejtës së pacientit për vendimmarrje në trajtimin e tij;
3. Përfshirja në marrëveshje apo marrëveshje biznesi e cila do t'ia cenonte të drejtën e pacientit për përzgjedhje të trajtimit apo të kujdesit shëndetësor;
4. Shpifja kolegjiale apo mashtrimi me qëllim të diskreditimit profesional të kolegëve;
5. Dhënia e informacionit të rrejshëm me qëllim të diskreditimit të kolegëve që kanë kërkuar atë informacion nga ju;
6. Mospërkrahja e aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe përparimin e fizioterapeutëve

#### **Neni 16**

##### **Shkeljet Etike për të cilat shqiptohet masa disiplinore – Arsimim shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim**

1. Refuzimi i dhënies së këshillave profesionale pacientëve gjatë ushtrimit të profesionit
2. Me rastin e konstatimit se fizioterapeutët nuk ka qenë aktiv në zhvillimin dhe përparimin e njohurive profesionale.



#### **Neni 17**

### **Shkeljet Etike për të cilat shqiptohet masa disiplinore – Trajtimi i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe vese të tjera**

1. Mosrespektimi i etikës profesionale gjatë ushtrimit të profesionit.
2. Ushtrimi i profesionit nën ndikimin e alkoolit apo drogës.

#### **Neni 18**

### **Shkeljet Etike për të cilat shqiptohet masa disiplinore – Tërheqja e përkohshme ose e përhershme e licencës dhe/ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri;**

1. Kur vendimit profesional i fizioterapeutit është i ndikuar nga interesi i tij personal qoftë ai profesional apo financiar.
2. Përsëritja e shkeljeve të njëjta më shumë se një herë apo konstatimi si recidivist i një fizioterapeuti.
3. Mos dokumentimi i kontrollit (vizitës) të pacientit me anë të dokumentacionit mjekësore
4. Mospërdorimi dhe keqpërdorimi i faksimilet nga ana e fizioterapeutit

#### **Neni 19**

### **Shkeljet Etike për të cilat shqiptohet masa disiplinore – Dënimi me të holla një mijë (1.000) deri në tre mijë (3.000) Euro**

1. Tentimi i ikjes së përgjegjësi për punën e kryer nga vet ai apo nga personi nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të tij.
2. Kur konstatohet se fizioterapeuti nuk ka reaguar edhe pse ka identifikuar se procedurat, kushtet e punës apo performancë profesionale e tij ndikojnë negativisht në sigurinë apo shëndetin e qytetarit/pacientit.
3. Fshehja e konfliktit të interesit nga ana e fizioterapeutit në rastet kur ekziston një rast i tillë.
4. Shkelja e cilit do nën të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr. 04/L-150 si dhe Statutit të Odës së Fizioterapeutëve.
5. Keqpërdorimi i titujve profesional e shkencorë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së fizioterapeutit
6. Mos lëshimi i raportit fizioterapeutik pas trajtimit të pacientit.





**Neni 20**  
**Dispozitat kalimtare**

1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Kodit etik dhe deontologji së fizioterapeutëve, bëhen sipas procedurës që i ka paraprirë nxjerrjes së Kodit etik dhe deontologjisë.

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi nga 1 Janar i vitit 2022 me nënshkrim nga Kryetari i OFTK-së.
2. Me hyrjen në fuqi të KODI ETIK DHE DEONTOLOGJISË, shfuqizohen të gjitha aktet e mëparshme që janë nga fushëveprimi i KODI ETIK DHE DEONTOLOGJISË të kaluar.

**Prishtinë**  
**Datë: 23.12.2021**

**Kryetari i OFTK-së**  
**Ass MSc Feim Gashi PT**

